

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj për “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike””
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Brendshme
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Data/Asnjë konsultim publik
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Data e vlerësimit të ndikimit
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Viti– ML – Nr. VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Katerina Gjorgo Email: katerina.gjorgo@mb.gov.al Numri i telefonit: 0693622654

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Përgjatë zbatimit të ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, nga kontrollet e ushtruara ndaj subjekteve që kryejnë këtë veprimtari, janë evidentuar disa problematika, konkretisht:

- Moszbatimi i dispozitave të Kodit të Punës, lidhur me kohëzgjatjen e punës, punën e natës, punën me turne, si dhe trajtimi sipas dispozitave ligjore e nënligjore që referojnë pagën minimale të punonjësit të shërbimit të SHPSF-ve.
- Problematika në nivel teknik dhe menaxherial, si menaxhimi jo i mirë i shërbimeve nga drejtuesit teknik të SHPSF-ve, bashkërendimi i punës midis DVP-ve dhe subjekteve të SHPSF dhe kontrolli ndaj këtyre të fundit, mos bashkëpunimi me strukturat e tjera ligj zbatuese si me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Zyrën e Inspektoratit të Punës,
- Kontratat e nënshkruara midis subjekteve të SHPSF dhe institucioneve publike/jopublike, jo të gjitha janë të specifikuara në zëra lidhur me numrin e vendrojave për sigurimin e objekteve, transportimin dhe shoqërimin e vlerave monetare, çmimin e kontraktuar për një punonjës shërbimi, etj.
- Agjencia e Prokurimit Publik ka konstatuar se prokurimi i ruajtjes me punonjës shërbimi të SHPSF, ka sjellë mjaft problematika ndër vite, të cilat janë fokusuar në drejtim të përllogaritjes së fondit limit, ofertimit në këto procedura dhe procesit të ankimimit.

- Nga disa subjekte të SHPSF, nuk respektohet detyrimi ligjor për të planifikuar dhe realizuar shërbim referuar koeficientit 1.66 punonjës policie për vendroje.
- Punonjësve të shërbimit megjithëse punojnë për 30 apo 31 ditë në muaj (përjashto muajin shkurt), në listë pagesat e dorëzuara për efekte të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore apo shëndetësore, u shënohen vetëm 22 ditë pune.
- Subjektet e SHPSF-ve, kanë bërë pagesa të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit, duke marrë për bazë pagën minimale bruto dhe jo pagën që punonjësi duhet të marrë për punën reale që ai bën gjatë një muaji, për rrjedhojë vlera e këtyre është e vogël.
- Subjektet e SHPSF vendosin vlerë page jo të përshtatshme referuar kërkesës së tregut dhe procedurave të prokurimit që kanë kryer me institucionet publike;

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

- Forcimi i rregullave të rekrutimit në subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike, me qëllim parandalimin dhe përjashtimin e personave të papërshtatshëm.
- Rritjen e efikasitetit të kontroleve të strukturave të Policisë së Shtetit ndaj këtij shërbimi, duke vendosur një regjim të rreptë kontrolli dhe monitorimi, sepse ende nga subjektet e SHPSF ka shkelje të ligjit, mos plotësim të detyrimeve ndaj punonjësve të punësuar, etj.
- Forcimin e regjimit të kontrollit të armatimit në zotërim të këtyre subjekteve, duke bërë reduktimin e tyre dhe eliminimin e armatimit ushtarak të sulmit nga arsenali i tyre.
- Parashikimin e masave shtrënguese në drejtim të automjeteve të blinduara që këtij shërbimi që i janë dhënë në dispozicion, duke lejuar përdorimin e tyre vetëm për qëllimin për të cilat ato janë miratuar.
- Përcaktimin e kriterëve dhe detyrimeve të subjekteve të licencuara për nënkategorinë 1.3C “Qendër e Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF”.
- Rritja e efektivitetit të këtij shërbimi.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 0 – status quo-ja; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma legjislative nuk përmbush objektivat e përcaktuara më sipër duke mos adresuar problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të ligjit nr. 75/2014.

Opsioni 1 (rregullator): – Miratimi i një projektligji të ri, që konsiston në hartimin e disa ndryshimeve apo/dhe shtesave në ligjin aktual nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

Opsioni 2 (rregullator): – Rregullimi me ligj të ri duke shfuqizuar ligjin nr. nr. 75/2014 dhe të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se

10 rreshta)

Opsioni i preferuar është ndryshimi i ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe shoqërohet me këto ndikime:

Ndikimi ekonomik:

Ndikime me vlerë monetare

1. Impakt ekonomik direkt për bizneset që ushtrojnë këtë veprimtari për shkak të trajnimeve të personelit, ngritja apo reduktimi i Qendrave të Kontrollit të Shërbimeve, në varësi të nevojës, sipas territorit ku ushtrojnë veprimtarinë, si dhe trajtimi i rregullt financiar i personelit.

2. Kosto ekonomike indirekte për bizneset që ushtrojnë këtë veprimtari nuk ka.

Kosto në buxhetin e shtetit:

Nisma ligjvënëse që synohet të ndërmerret nuk parashikon kosto direkte apo indirekte për buxhetin.

Ndikimet sociale:

- Rritja e sigurisë dhe rendit publik;
- Rritja e besimit të opinionit publik në sutoritetin mbikëqyrës e kontrollues;
- Rermirësimi i trajtimit financiar të punës apo trajtimi në masën e duhur sipas akteve ligjore e nënligjore përkatëse në fuqi;
- Reduktimi i shfrytëzimit të punonjësve që punojnë në të zezë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është:

Opsioni 1 (rregullator): – Miratimi i një projektligji të ri, që konsiston në hartimin e disa ndryshimeve apo/dhe shtesave në ligjin aktual nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

Është përzgjedhur për të ndryshuar dhe për të bërë shtesa në ligjin nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, sepse pas analizës dhe vlerësimit ndryshimet apo shtesat që nevojiten për rregullimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të këtij ligji nuk janë në masën që të nevojitet një ligj i ri. Ndryshimet në ligjin ekzistues janë të mjaftueshme, duke shtuar se ky ligj nuk ka pësuar ndryshime që nga hyrja në fuqi e tij.

Opsioni i zgjedhur është vlerësuar i përshtatshëm për arritjen dhe përmbushjen e objektivave. Masa e ndryshimeve dhe shtesave janë të lehta për tu kuptuar dhe përshtatur normalisht në sistemin ekzistues ligjor.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti <u>1</u>	Viti <u>2</u>	Viti <u>3</u>
0	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 59, datë 09.05.2022, me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë.

Ky projektligj është konsultuar në mbledhjet e grupit të punës, përkatësisht në datat 19.05.2022, 31.05.2022, 10.06.2022, 17.06.2022 dhe 01.07.2022.

Referuar ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projekt aktit, përfundon brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Autoritetet që do ngarkohen me zbatimin dhe monitorimin e ligjit do të jenë strukturat e rendit në nivel qendror dhe vendor, Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, zbatimi i këtij akti do të arrihet edhe nëpërmjet ndryshimeve që priten të ndryshohen në Udhëzimi e Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, i ndryshuar, i cili do të përcaktojë rregullat e detajuar për zbatimin e ndryshimeve në ligjin nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” është vlerësuar një instrument ligjor që do të adresojë problematikat e hasura gjatë procedurave të monitorimit dhe inspektimit të kësaj veprimtarie. Për pasojë, ky projektligj u vlerësua të jetë pjesë e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për vitin 2022, për Ministrinë e Brendshme, miratuar me vendimin nr. 850, dt. 29.12.2021 të Këshillit të Ministrave.

Shërbimi privat i sigurisë fizike në vendin tonë ushtron aktivitetin dhe funksionimin e tij, që nga viti 1993 me një përvojë mëse 29 vjeçare në fushën private të sigurisë fizike. Ky shërbim ka si objektiv të veprimtarisë së tij sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, të personave, të veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare dhe politike, sigurimin e shoqërimit e vlerave monetare, materiale e sendeve të

çmuara gjatë transportit, si dhe trajnimin dhe kualifikimin e personelit të këtij shërbimi nëpërmjet Qëndrave të Trajnimit Privat.

Menaxhimi i këtij shërbimi bëhet kryesisht nga ish punonjës policie të niveleve të ndryshme dhe ish ushtarakë të forcave të armatosura që kanë mbaruar arsimin e lartë policor ose ushtarak, të cilët janë drejtuesit më të lartë teknik për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e tij.

Ndryshimet dhe shtesat priten të fokusohen në rregullimin e disa problematikave, me synim forcimin e kriterëve që nga marrja e licencës, trajnimi i punonjësve dhe ushtrimi i veprimtrisë së këtij shërbimi, me anë të së cilave rritet efektiviteti i këtij shërbimi.

Projektligji nuk ka për qëllim të përafrohet me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Përveç se sa më sipër, projektligji hartohet edhe në zbatim të Prioriteteve të Ministrisë së Brendshme dhe të detyrave të Programit Vjetor të DPPSH për vitin 2022.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Veprimtaria e SHPSF rregullohet me ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i cili shfuqizoi ligjin e mëparshëm nr. 8770, datë 19.04.2001 “Për shërbimin e ruajtjes e sigurisë fizike”.

Me qëllim krijimin e kushteve për një treg më të mirë privat të sigurisë, ligji hoqi një sërë pengesash ligjore që dëmtonin konkurrencën, pengonin rritjen e investimeve të SHPSF-ve si dhe e hapi tregun shqiptar për operatorët ndërkombëtarë.

Përveç kësaj, ai synoi përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke u bërë të mundur SHPSF-ve të rekrutojnë dhe të mbajnë një fuqi punëtore më cilësore dhe më të motivuar, duke përcaktuar si pagë minimale për punonjësit privat të sigurisë, atë prej 50% më të lartë se paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi.

Shoqëritë private të sigurisë fizike ushtrojnë aktivitetin e tyre të licencuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

Aktualisht sipas të dhënave të 3-të mujorit të parë 2022, në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin 189 subjekte të shërbimit privat të sigurisë fizike për tre kategoritë, me 8737 punonjës shërbimi, kanë në ruajtje 2665 objekte, 787 automjete, nga të cilat 200 automjete të blinduara për transportimin e vlerave monetare, shërbimi ka në dispozicion 2055 armë zjarri etj.

Problematikat e identifikuar në veprimtarinë e SHPSF-ve nga kontrollet e ushtruara ndaj këtij shërbimi, kanë evidentuar mos zbatimin e plotë të ligjit dhe konkretisht:

- Mos zbatimi i dispozitës për pagën minimale të punonjësit të shërbimit, e cila është evidentuar si një nga problemet kryesore nga Policia e Shtetit gjatë kontrollit dhe inspektimeve të kryer për subjektet e SHPSF-së.
- Mos zbatimi i dispozitave të Kodit të Punës, që lidhen me kohëzgjatjen e punës,
- Nuk janë ngritur dhe funksionuar qendrat e kontrollit të shërbimeve nga të gjitha subjektet (neni 22, në çdo njësi administrative, apo në nivel qarku).

- Menaxhimi jo i mirë i shërbimeve nga drejtuesit teknik të SHPSF-ve, bashkërendimi i punës midis DVP-ve dhe subjekteve të SHPSF dhe kontrolli ndaj këtyre të fundit.
- Bashkëpunim më të mirë me strukturat e tjera ligjzbatuese si me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Zyrën e Inspektoratit të Punës, etj.
- Kontratat e nënshkruara midis subjekteve të SHPSF dhe institucioneve publike/jopublike, jo të gjitha janë të specifikuara në zëra lidhur me numrin e vendrojave për sigurimin e objekteve, transportimin dhe shoqërimin e vlerave monetare, çmimin e kontraktuar për një punonjës shërbimi, shërbim për verifikimin e sinjalit të alarmit me grup të gatshëm, të vëzhgimit (kamerave) dhe për mirëmbajtje të sistemeve, shërbimin GPS / GPRS për automjetet etj.
- Subjektet e SHPSF zbatojnë çmime të ndryshme për punonjës, në varësi me kërkesën e tregut dhe procedurat e prokurimit që kanë kryer me institucionet publike.
- Agjencia e Prokurimit Publik ka konstatuar se prokurimi i ruajtjes me punonjës shërbimi të SHPSF, ka sjellë mjaft problematika ndër vite, të cilat janë fokusuar në drejtim të përlogaritjes së fondit limit, ofertimit në këto procedura dhe procesit të ankimimit.
- Nga disa subjekte të SHPSF, nuk respektohet detyrimi ligjor për të planifikuar dhe realizuar shërbim referuar koeficientit 1.66 punonjës policie për vendroje.
- Punonjësit e shërbimit jo në të gjitha rastet i gëzojnë të drejtat e përcaktuara në nenet 78, 81, 85 e 86 të Kodit të Punës dhe nga ligji nr. 75/2014, të drejta të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e pagesës për punën e bërë natën, orët e punës në turnin e dytë, etj.
- Punonjësve të shërbimit megjithëse punojnë për 30 apo 31 ditë në muaj (përfshijë muajin shkurt), në listë pagesat e dorëzuara për efekte të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore apo shëndetësore, u shënohen vetëm 22 ditë pune.
- Subjektet e SHPSF-ve, kanë bërë pagesa të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit, duke marrë për bazë pagën minimale bruto dhe jo pagën që punonjësi duhet të marrë për punën reale që ai bën gjatë një muaji, për rrjedhojë vlera e këtyre është e vogël.

Për shkeljet e evidentuara gjatë kontrolleve, si dhe shkelje të tjera, janë mbajtur procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes administrative ndaj subjekteve të SHPSF-së, cilat janë shqyrtuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim në DVP dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke marrë masa administrative, deri në propozim të heqjes së licencës apo certifikatës.

Pas miratimit të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, janë nxjerrë aktet nënligjore për implementimin dhe zbatimin e tij në praktikë, ku u përcaktua dokumentacioni dhe procedurat për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit për certifikimin e drejtuesit teknik dhe titullarit të subjektit SHPSF-së dhe QTP-së.

Në këtë kuadër u përgatit dhe u miratua Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 157, datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”. Gjatë zbatimit në praktikë të këtij udhëzimi, u konstatuan disa probleme, si disa vjedhje me armë (grabitjeve) të eskortave të SHPSF-ve që shoqëronin vlerat monetare, mos parashikimin e licencimit të dhe të funksionimit të Qendrave të Trajnimit Privat, të punonjësit e SHPSF-së, sipas përcaktimit në nenin 29 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, mungesa e kapaciteteve nga ana e Akademisë së Sigurisë për përballimin në vijimësi të trajnimeve të aftësimin teorik dhe praktik të punonjësve të SHPSF, mungesa e përcaktimit në një VKM të licencës të nënkategorisë 1.3.C “Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të Shërbimit të SHPSF-së”, etj.

Në vlerësim të problematikave të mësipërme dhe të bashkëpunimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Qendrën Kombëtare të Biznesit, u hartua dhe u miratua VKM nr. 301, datë 05.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 538, datë 26.05.2009, për licencat dhe lejet që trajtohen nga / apo / nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkët”, i ndryshuar.

Miratimi i këtij akti, bëri të domosdoshme hartimin e Udhëzimit të ri “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së” i cili u miratua me

urdhër të MPB nr. 308, datë 22.05.2017 dhe hyri në fuqi me botimin në fletoren zyrtare nr. 128, datë 07.06.2017.

Standardet e parashikuara në udhëzim do të sillnin një impakt pozitiv në aktivitetin e SHPSF-ve të nënkategorisë 1.3.B, duke reduktuar numrin e tyre, i cili do të ndikonte në rritjen e standardeve dhe cilësinë e këtyre shoqërive, si dhe do të shmangte konkurrencën e pa ndershme gjatë procesit të tenderimit të këtij shërbimi (ndër të tjera në udhëzim, u përcaktuan rregulla dhe kriteret të qarta për transportimin e vlerave monetare, nga subjektet e pajisur me licence të nënkategorisë 1.3.B).

Gjithashtu, një impakt pozitiv i Udhëzimit nr. 308, evidentohet edhe në drejtim të ngritjes dhe funksionimit të Qendrave të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së, ku fillimisht u licencuan 5 subjekte të nënkategorisë 1.3.C.

Akademia e Sigurisë, në funksion të trajnimit të punonjësve të SHPSF-ve, hartoi dhe miratoi programet e trajnimit që u zhvilluan si në Akademinë e Sigurisë ashtu edhe në QTP të punonjësve të SHPSF-së dhe së bashku me QTP filluan trajnimet e punonjësve të shërbimit.

Me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 899, datë 14.09.2017 “Për anulimin e udhëzimit nr. 308 datë 22.05.2017, të Ministrit të Punëve të Brendshme “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrave të Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së”, u anulua udhëzimi nr. 308 datë 22.05.2017. Në vijim të kësaj detyre, DPPSH ngriti grupin e punës me urdhër nr. 1037, datë 17.10.2017 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës për hartimin e Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së”.

Udhëzimi i ri i Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, konsideroi dhe reflektoi disa nga sugjerimet e grupeve të interesit (Departamenti i Sigurisë i Bankës së Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Komiteti i Sigurisë Fizike të Bankave të Nivelit të dytë, Unioni i SHPSF-së “Security Albania”, subjekte të SHPSF-ve dhe QTP), si dhe të Akademisë së Sigurisë.

Nga strukturat vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit janë ushtruar kontrole të vazhdueshme për përmirësimin e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike dhe eliminimin e të metave dhe mangësive të konstatuara. Vetëm për 3 mujin e vitit 2022 janë konstatuar 8 ngjarje të ndryshme në objektet që siguron shërbimi privat i sigurisë fizike.

Nga kontrollet e ushtruara nga strukturat vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit për këtë periudhë janë vendosur 21 masa administrative ndaj subjekteve apo punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike, janë hequr 2 certifikata titullar subjekti/drejtuës teknik dhe 7 licenca të SHPSF-ve.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qeveria ndërhyr në fushat që nuk kanë arritur rezultatet e pritshme bazuar në masat që janë ndërmarra dhe për këtë rast për të trajtuar sistemin rregullator ligjor lidhur me veprimtarinë e SHPSF-ve.

Hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” është vlerësuar një instrument ligjor që do të adresojë problematikat e hasura gjatë procedurave të monitorimit dhe inspektimit të kësaj veprimtarie. Për pasojë, ky projektligj u vlerësua të

jetë pjesë e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për vitin 2022, për Ministrinë e Brendshme, miratuar me vendimin nr. 850, dt. 29.12.2021 të Këshillit të Ministrave.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje legislative synohet zbatimi i Prioriteteve të Ministrisë së Brendshme dhe të detyrave të Programit Vjetor të DPPSH për vitin 2022.

Ndërhyrja është e domosdoshme, pasi duke marrë në konsideratë situatën ligjore dhe situatën ekzistuese *de facto*, duhet të rritet efektiviteti i këtij shërbimi.

Nëpërmjet kësaj iniciative ligjore, janë adresuar çështje, të përcaktuara më poshtë, të cilat bëjnë të mundur realizimin konkret të objektivave të mësipërm, me qëllim përmirësimin e kontrollit kufitar.

Produkti përfundimtar që pritët të arrihet me miratimin e këtij projektligji është rregullimi i veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike në disa drejtime dhe përmirësimi i tyre, për të cilat në ligjin aktual janë konstatuar mangësitë e mësipërme.

Miratimi i këtij projektligji do të sjellë rritjen e efektivitetit të punës së shërbimit privat të sigurisë fizike, për sigurimin e objekteve të rëndësishme, të vlerave monetare dhe për trajnimin e personelit të këtij shërbimi, vendosjen e një raporti më të drejtë të ushtrimit të kontrollit të strukturave të Policisë së Shtetit ndaj këtij shërbimi, me qëllimin final kontributin e tij për parandalim, zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprave penale, atje ku ky shërbim është kontraktuar nga subjektet e ndryshme dhe kryen funksionet e tij.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, duke përzgjedhur opsionin 2, ndryshimi i ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, synohet të realizohen objektivat e mësipërm, nëpërmjet rregullimit dhe qartësimit të dispozitave ligjore, duke rritur edhe efikasitetin e mekanizmit të mbikëqyrjes së zbatimit të kuadrit ligjor që normon veprimtarinë në fjalë.

Qeveria ndërhyr në fushat që nuk kanë arritur rezultatet e pritshme bazuar në masat që janë ndërmarrë dhe për këtë rast për të trajtuar sistemin rregullator ligjor lidhur me veprimtarinë e SHPSF- ve.

Hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” është vlerësuar një instrument ligjor që do të adresojë problematikat e hasura gjatë procedurave të monitorimit dhe inspektimit të kësaj veprimtarie. Për pasojë, ky projektligj u vlerësua të jetë pjesë e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për vitin 2022, për Ministrinë e Brendshme, miratuar me vendimin nr. 850, dt. 29.12.2021 të Këshillit të Ministrave.

Nëpërmjet kësaj nisme synohet rregullimi i veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike në disa drejtime dhe përmirësimi i tyre, për të cilat në ligjin aktual janë konstatuar mangësitë e mësipërme.

Për hartimin e projektligjit grupi i punës që përfshin përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe të Akademisë së Sigurisë, pas kryerjes së disa takimeve ka dalë në një rezultat final.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Ky propozim synon:

- Të forcojë rregullat mbi rekrutimin në subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike, me qëllim parandalimin dhe përjashtimin e personave të papërshtatshëm;
- Të rritë efikasitetin e kontroleve të strukturave të Policisë së Shtetit ndaj këtij shërbimi, duke vendosur një regjim të rreptë kontrolli dhe monitorimi, sepse ende nga subjektet e SHPSF ka shkelje të ligjit, mos plotësim të detyrimeve ndaj punonjësve të punësuar, etj.;
- Të forcojë regjimin e kontrollit të armatimit në zotërim të këtyre subjekteve, duke bërë reduktimin e tyre dhe eliminimin e armatimit ushtarak të sulmit nga arsenalit i tyre;
- Të parashikojë masat shtërguese në drejtim të automjeteve të blinduara që këtij shërbimi i janë dhënë në dispozicion, duke lejuar përdorimin e tyre vetëm për qëllimin për të cilat ato janë miratuar;
- Të përcaktojë kriteret dhe detyrimet e subjekteve të licencuara për nënkategorinë 1.3C “Qendër e Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF”;
- Të rritë efektivitetin e këtij shërbimi.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsioni 0: status quo-ja- Ky opsion nuk sjell asnjë ndryshim. Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma legjislative nuk përmbush objektivat e përcaktuara më sipër. Të mos ndërmarrësh asnjë veprim do të thotë të mbahet kuadri ligjor që është i papërshtatshëm.

Opsioni 1 (rregullator): – Ndryshimi i ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, vlerësuar i përshtatshëm për arritjen dhe përmbushjen e objektivave. Masa e ndryshimeve dhe shtesave janë të lehta për tu kuptuar dhe përshtatur normalisht në sistemin ekzistues ligjor. Ndryshimet në ligjin ekzistues janë të mjaftueshme, duke shtuar se ky ligj nuk ka pësuar ndryshime që nga hyrja në fuqi e tij.

Opsioni 2 (rregullator): – Hartimi i një ligj të ri që përcakton dispozita me detyrime për këtë veprimtari, i nënshtrohet një procedure dhe ekspertize të gjatë në kohë për hartimin dhe miratimin e tij, ndërkohë pas analizës dhe vlerësimit ndryshimet apo shtesat që nevojiten për rregullimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të këtij ligji nuk janë në masën sa që të nevojitet një ligj i ri.

Pas analizimit të të gjithë elementëve si më sipër, mbetet si opsion i preferuar ndryshimi i ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, si opsioni që do të përmirësonte situatën aktuale, pasi krahasimisht me hartimin dhe miratimin e një ligji ri, ky opsion i nënshtrohet një afati kohor më të shkurtër kohor dhe është në koherencë dhe i ndërlidhur.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*

- Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).
- Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).

Opsioni 0 nuk ka kosto direkte, por nuk ka përfitime.

Opsioni 1 nuk sjell efekte financiare. Afati i gjatë kohor nuk është element i preferuar dhe të hartimi i një ligj të ri, që përcakton dispozita me detyrime për këtë veprimtari, i nënshtrohet një procedure dhe ekspertize të gjatë në kohë për hartimin dhe miratimin e tij, ndërkohë që interesi është adresimi i problematikave, brenda një kohe sa më të shkurtër dhe në mënyrën më efektive.

Opsioni 2, hartimi i një ligj të ri që përcakton dispozita me detyrime për këtë veprimtari, përsëri nuk ka kosto, si opsioni 1, por i nënshtrohet një procedure dhe ekspertize të gjatë në kohë për hartimin dhe miratimin e tij, ndërkohë pas analizës dhe vlerësimit ndryshimet apo shtesat që nevojiten për rregullimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të këtij ligji nuk janë në masën sa që të nevojitet një ligj i ri.

Ndikimet në mjedis

Nuk ka ndikim në mjedis.

Ndikimet sociale

Në këtë aspekt, ky mjet është i nevojshëm për rritjen e sigurisë dhe rendit publik, rritjen e besimit të opinionit publik në sutoritetin mbikëqyrës e kontrollues, përmirësimin e trajtimit financiar të punës apo trajtimi në masën e duhur sipas akteve ligjore e nënligjore përkatëse në fuq, reduktimin e shfrytëzimit të punonjësve që punojnë në të zezë.

Opsioni i preferuar është ndryshimi i ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe shoqërohet me këto ndikime:

Ndikimi ekonomik:

Ndikime me vlerë monetare

1. Impakt ekonomik direkt për bizneset që ushtrojnë këtë veprimtari për shkak të trajnimeve të personelit, ngritja apo reduktimi i Qendrave të Kontrollit të Shërbimeve, në varësi të nevojës, sipas territorit ku ushtrojnë veprimtarinë, si dhe trajtimi i rregullt financiar i personelit.

2. Kosto ekonomike indirekte për bizneset që ushtronë këtë veprimtari nuk ka.

Kosto në buxhetin e shtetit:

Gjithashtu, zbatimi i këtij akti do të arrihet edhe nëpërmjet ndryshimeve që priten të ndryshohen në Udhëzimi e Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, i ndryshuar, i cili do të përcaktojë rregullat e detajuar për zbatimin e ndryshimeve në ligjin nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

Nisma ligjvënëse që synohet të ndërmerret nuk parashikon kosto direkte apo indirekte për buxhetin.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 1 (rregullator): – Është përzgjedhur për të ndryshuar dhe për të bërë shtesa në ligjin nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, sepse pas analizës dhe vlerësimit ndryshimet apo shtesat që nevojiten për rregullimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të këtij ligji nuk janë në masën që të nevojitet një ligj i ri. Ndryshimet në ligjin ekzistues janë të mjaftueshme, duke shtuar se ky ligj nuk ka pësuar ndryshime që nga hyrja në fuqi e tij. Opsioni i zgjedhur është vlerësuar i përshtatshëm për arritjen dhe përmbushjen e objektivave. Masa e ndryshimeve dhe shtesave janë të lehta për tu kuptuar dhe përshtatur normalisht në sistemin ekzistues ligjor.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Masat e monitorit dhe të vlerësimit do të arrihen në të njëjtën mënyrë si ligji aktual, konkretisht do të realizohet nga autoritetet që dispozitat ngarkojnë me këtë përgjegjësi, si strukturat e rendit në nivel qendror dhe vendor, të cilat bëjnë inspektive, si dhe Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin -										

në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur = Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale										
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës										
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

MINISTËR

Bledar ÇUÇI